

Deri te:

Këshilli Mësimor- Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës

Në bazë të vendimit nr. 19-127/3 të Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës nga mbledhja e mbajtur më 12.11.2018 për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull "Dallimet e disa karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorike te studentët e Universitetit të Tetovës", të kandidatit Mr.sc. Blerim Sulejmani, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Isa Asllani – Kryetar, Prof. Dr. Metin Dalip – anëtar, Prof. Dr. Fadil Rexhepi – anëtar, Prof. Dr. Haki Ismaili – anëtar, Prof. Dr. Prof. Visar Ganiu – mentor, Këshillit Mësimor Shkencor i paraqet këtë:

R A P O R T

Për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Mr. sc. Blerim Sulejmani ka lindur në Tetovë në vitin 1979, Shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në Tetovë. Ndërkohë, Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës më 2004. Në vitin 2011 mbaroi magjstraturën në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sporteve në Universitetin e Prishtinës dhe morri titullin Magjistër i Shkencave Sportive.

Përvoja profesionale

Nga viti 2004 është angazhuar si asistent në Fakultetin e Kulturës Fizike me marrëveshje për bashkëpunim me honorar, deri në vitin 2015. Nga viti 2005 deri më 2015 është angazhuar edhe si profesor i Kulturës Fizike dhe Sporteve në Gjimnazin e Tetovës. Nga viti 2015 është angazhuar si asistent I rregullt në lëndën e kulturës Fizike dhe sporteve në Universitetin e Tetovës.

Deri më tani, Mr. sc. Blerim Sulejmani ka botuar këto punime shkencore:

1. Shakiri Kastriot, Zaborski Boško, Sulejmani Blerim, Kostovski Žarko (2015) Differences in the morphological characteristics ëith athletes and non-athletes at the age of 16-18 years. International scientific journal of kinesiology Vol. 8 (2015), Issue 2.
2. Shaqiri Kastriot, Ameti Vullnet, Mamuti Fadil, Memishi Shpresa, Rexhepi Agim, Sulejmani Blerim (2015). Anxiety Among Athletes Of Individual Sports During Adolescence.

International Balkan Sport Sciences Congress (Ibssc 2015) And 8 International Kirkpinar Symposium, May 2015, Edirne, Turkey.

3. Blerim SULEJMANI, Kastriot SHAQIRI, Fadil MAMUTI, Agim REXHEPI, (2016) THE IMPACT OF SOME MORPHOLOGICAL CHARACTERISTICS IN KARATE. International Balkan Sport Sciences Congress (Ibssc 2016)

4. Blerim SULEJMANI, Vullnet AMETI, Kastriot SHAQIRI, Astrit ISENI, Blerim SAITI (2017), THE IMPACT OF SOME MOTOR CHARACTERISTICS AND MOTOR SKILLS IN KARATE, Fourth International Balkan Conference in Sport Sciences Ibcss2017 Faculty of Physical Education University of Tetova

5. Kastriot Shaqiri, Diellza Kelmendi, Blerim Sulejmani, Shpresa Memishi, Agim Rexhepi, (2017) ANXIETY BETË EEN ATHLETES OF INDIVIDUAL SPORTS, COLLECTIVE SPORTS AND NON-ATHLETES DURING ADOLESCENCE, The International Balkan Conference in Sport Sciences (IBCSS 2017), May 2017, Bursa, Turkey.

6. Blerim Sulejmani, Vullnet Ameti, Kastriot Shaqiri, Visar Ganiu, Dardan Dehari (2017), THE IMPACT OF SOME MORPHOLOGICAL CHARACTERISTICS IN KARATE, International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health. UDC:796-613-7 ISSN:1857-9310 (Print) Vol.4/No. 7-8, pp 17-21.

7. Blerim Saiti, Agron Ademi, Blerim Sulejmani, Haki Ismaili Physical Education free learning, recreation and entertainment activity. State University of Tetova – Faculty of Physical Culture, Tetovë, Macdonia

8. Astrit Iseni, Isa Asllani, Blerim Sulejmani, Ridvan Bilalli The structure and specific motor skills to students from years old Faculty of Physical Education- Tetovo and Primary school "Vasil Glavinov", Buzalikov – Veles, Macedonia, April 2016

9. Blerim Sulejmani, Astrit Iseni, Zoran Radiç, Isa Asllani, Aleksandar Simeonov Canonical correlation between some basic-motor and specific -motor capacities of elementary school pupils

Në vitin 2015 regjistroi studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Fakultetin e Kulturës Fizike – drejtimi kineziologji, Në vitin 2018 pasi ka dhënë të gjitha provimet, ka përgatitur tezën e disertacionit të doktoraturës me temën "Dallimet e disa karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorike te studentët e Universitetit e Tetovës", me mentor, Prof. Dr. Visar Ganiu.

Përmes këtij hulumtimi ai ka synuar të verifikojë sesa mund të ndikojnë kushtet e punës dhe programet e përpiluara nëpër mësimin e statusit morfologjik dhe motorik te studentët, të cilët me planprogram kanë përcjellë lëndën sport dhe aktivitete sportive ne Universitetin e Tetovës. Pasi procesi mësimor paraqet dukuri komplekse, e cila l nënshtrohet ndikimit të madh të faktorëve të ndryshëm, përmes këtij kërkimi shkencor është arritur të vërtetohet se cili është efekti i dimensioneve të ndryshme motivuese në suksesin përfundimtar në lëndën e sportit, në kushtet dhe rrethanat në të cilat punohet. Aktivitetet e përgjithshme kineziologjike posedojnë rolin dominant në transformimin e statusit antropologjik të njeriut. Njohja e dimensioneve të statusit psikosomatik të të rinjve hap rrugën për zgjedhjen dhe zbatimin e operatorëve përkatës kineziologjikë. Rinia studentore sipas plan-programit mësimorë, është e përfshirë në aktivitetet fizike vetëm me dy orë javë gjatë mësimin të lëndës së sportit dhe edukatës fizike.

Sa i plotëson nevojat e organizmit të të rinjve aktiviteti fizik vetëm dy orë në javë është një çështje të cilës nuk i është dhënë përgjigje adekuate profesionale. Në kohën e sotme është më e nevojshme se asnjëherë më parë rritja e aktiviteteve lëvizore, të cilët paraqesin njërin nga motivet elementare të njeriut. Jeta bashkëkohore, e cila me vete ka sjellur të rejtat e teknikës dhe teknologjisë, të cilat në njërin anë rrisin efektivitetin në punë, por në anën tjetër njeriun e bëjnë pasiv, duke qëndruar i ulur, pranë kompjuterit dhe mjeteve të tjera teknike në punë. Kjo veçanërisht e kanos organizmin e të rinjëve, të cilëve aktiviteti fizik në Universitet, i limituar vetëm në dy orë në javë, as për së afërmi nuk ua plotëson nevojat e tyre elementare për lëvizje. Numër i madh i kërkimeve vërtetojnë se zbatimi i drejtë i ushtrimeve fizike ndihmon aparatin lokomotor, frymë këmbimin, sistemin e qarkullimit të gjakut, si dhe organet dhe sistemet tjera të organizmit të njeriut. Aplikimi sistematik dhe i drejtë i ushtrimeve fizike ndikon në përmirësimin e forcës muskulore në të gjitha format e saj te studentët.

Disertacioni i doktoraturës i Mr. sc. Blerim Sulejmanit është strukturuar në kapituj

Në kapitullin e parë ka paraqitur hulumtimet e deritanishme, që janë realizuar në gjithë botën, në vende dhe rrethana nga më të ndryshmet, duke dhënë një pasqyrë të qartë të parametarve morfologjik edhe aftësive motorike te të rinjtë e grupmoshave të ndryshme.

Poashtu, kërkimet shkencore që janë realizuar mbi ndikimet e modeleve të ndryshme të edukimit sportiv ndaj motivimit të të rinjëve në më shumë aspekte. Abstraktet e hulumtit të kryera në rrethana dhe kushte të ndryshme, janë paraqitur me qëllim të pasqyrit të dallimeve të disa karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorikete studentët e Universitetit të Tetovës.

Në kapitullin e dytë të këtij disertacionit ai ka përcaktuar metodologjinë e hulumtimit duke vendosur lëndën për hulumtimin e karakteristikave dhe aftësitë e studentëve të vitit të parë,

pranë Universitetit të Tetovës (karakteristikat antropometrike dhe aftësitë motorike). Pastaj mbi qëllimin e punimit, ka realizuar analizën komperative të disa karakteristikave dhe aftësive në mes të studentëve meshkuj dhe femra si dhe ngritjen e hipotezave të disertacionit se nuk do të ekziston lidhshmëri në mes dy grupeve në hapësirën antropometrike, mirëpo do të ekzistoj lidhshmëri në mes hapësirës motorikete të dy grupet e veçanta (meshkuj dhe femra). Gjithashtu është ngritur hipoteza - se priten dallime kuantitative të karakteristikave antropometrike ndërmjet dy subjekteve të hulumtimit.

Ndërkohë që sipas hipotezave të ngritura priten dallime kuantitative të aftësive motorike ndërmjet dy subjekteve të hulumtimit. Po në këtë kapitull ka përkufizuar subjektet që ka përfshirë në këtë studim, student të vitit të parë, të Universitetit të Tetovës në drejtime dhe programe studimore të ndryshme.

Në studim janë përfshirë gjithsejt 200 studentë të cilët në vitin e parë përcjellin lëndën sport dhe aktivitete sportive. Gjithashtu janë përcaktuar testet dhe matjet e studimit për vlerësimin e të gjitha karakteristikave antropometrike dhe motorike. Si dhe në fund ka përcaktuar metodat e përpunimit të rezultateve.

Në kapitullin e tretë dhe shumë të rëndësishëm ka vendosur rezultatet dhe diskutimet për të gjitha matjet e veçanta që janë realizuar për vajzat dhe pastaj edhe për djemtë në të gjitha fakultetet e veç e veç, si statistika deskriptive të variablave antropometrike tek studentët e Fakultetit Filologjik, drejtimi i gjuhës Angleze, pastaj Gjuhë Gjermane, Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore, drejtimi Informatikë, Fakultetit të Shkencave të Ybatuara, drejtimi ndërtimtari Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Fakulteti Filozofik Edukim Special dhe Rehabilitim, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara. Rezultatet në situata dhe rrethana të ndryshme janë paraqitur në 20 tabela statistikore, të cilat një nga një i ka analizuar dhe diskutuar statistikat deskriptive të variablave antropometrike tek studentët meshkuj, duke paraqitur edhe të dhënat bazike statistikore të hapsirës latente motorike tek studentët dhe konstatimet në variablën e Kërcimit së gjati si dhe duke përcaktuar dhe diskutuar vlerat homogjene. Pastaj në Variablën Kërcim së larti, në Variablën Squat, ulje – ngritje më peshë 10kg, Në Variablën S ingle leg squat-ulje ngritje me një këmbë. Në Variablën Wall sit test-qëndrim statik me një këmbë të përthyer në kënd 90 shkallë.

Në Variablën Wall sit test me peshë-qëndrim statik me gjunjë të thyer në kënd 90 shkallë. Në Variablën Vrapim shpejtësie 10m-New test Në Variablën Vrapim shpejtësie 30m.

Në kapitullin e katërt ka paraqitur të dhënat në 16 tabela të ndryshme statistikore dhe ka realizuar analizat multi variante (manova) dhe uni variante (anova) e variaces në hapësirën antropometri ketek subjektet e testuara te meshkujt dhe pastaj te vajzat veçmas në fakultetet e ndryshme. Duke analizuar të dhënat e tabelave ka dhënë konstatimet në Analizat

multivariate (MANOVA) dhe univariate (ANOVA) e variancës së matjeve antropometrike në të gjitha grupet e subjekteve në hapsirën multivariate (MANOVA) në matjet antropometrike mbi dallimet statistikore mes tjerash me vlerat e Wilks' Lambda, Pillai's Trace, Hotelling's Trace, Roy's Largest Root. Ndërsa në analizat univariate të variancës (ANOVA) së matjeve antropometrike në të gjitha grupet e subjekteveka vlerësuar 17 variabla antropometrikme dallime statistikore në 6 variabla dhe ate në Gjatësia e këmbës së djathtë, Perimetri i krahut, Diametri i kyçit të gjurit, Diametri i kyçit të bërryli, Indi dhjamor nën lëkurorë në pulpë (calf) dhe Indi dhjamor nën lëkurorë në krah (biceps brachi).

Për të verifikuar cilat janë dallimet në mes të grupeve ku paraqiten dallime statistikore te variablavr në analizat univariante të variances (ANOVA), ka reaalizuar LSD – testitekata variablanë të ciliat na paraqiten dallime domethënëse statistikore.

Ndërkohë, në kapitullin e pestë ka paraqitur testet e variablave në 12 tabela dhe analizat multivariate (MANOVA) dhe univariate (ANOVA) të variances në hapsirën motorike në të gjitha grupet e subjekteve meshkuj dhe pastaj grupeve të vajzave.

Duke analizuar të dhënat e tabelave ka dhënë konstatime në analizat multivariate (MANOVA) dhe univariate (ANOVA) e variancës testeve për vlerësimin e hapësirës motorike në të gjitha grupet e subjekteve në hapësirën multivariate (MANOVA) në testeve motorike nëse ekzistojnë dallime domethënëse statistikore, mes tjerash me vlerat e Wilks' Lambda, Pillai's Trace, Hotelling's Trace, Roy's Largest Root.

Për të verifikuar cilat janë dallimet në mes të grupeve ku paraqitur dallimet statistikore të variablave në analizat univariante të variances (ANOVA), ka realizuar post host testi ose LSD – testi te këta variablanë të ciliat na paraqesin dallime domethënëse statistikore.

Kapitullin e gjashtë ua ka kushtuar analizave multivariante (manova) dhe univariante (anova) e variancës në matjet antropometrike tek të gjitha grupet mes vajzave dhe djemve. Gjithashtu, në këtë kapitull janë realizuar edhe analizat multivariante (manova) dhe univariante (anova) të variancës në testeve motorike tek të gjitha grupet mes vajzave dhe djemve.

Duke analizuar të dhënat e tabelave ka bërë konstatimet që në analizat multivariate (MANOVA) dhe univariate (ANOVA) e variances të testeve për vlerësimin e karakteristikave antropometrike në të gjitha grupet e subjekteve në mes vajzave dhe djemve të cilat i rezultojnë që në hapsirën multivariate (MANOVA) të matjeve antropometrike ekzistojnë dallime domethënëse statistikore me vlerat e Eilks' Lambda, Pillai's Trace, Hotelling's Trace, Roy's dhenëLargest Root. Ndërsa në analizat univariate të variancës (ANOVA) të testeve motorike në të gjitha grupet e subjekteve ka vlerësuar, që nga gjithsej 17 variabla për vlerësimin e karakteristikave antropometrike dallime domethënëse statistikore paraqiten në

13 variabla. Duke u bazuar në vlerat e mesit aritmetik, ka dhënë kostatimet se tek të gjitha variablat për vlerësimin e karakteristikave morfologjike rezultatet tregojnë në favor të grupeve të meshkujve në krahasim me grupet e vajzave.

Në fund të kapitujve i ka dhënë përfundimet, sugjerimet dhe rekomandimet e këtij hulumtimi.

Përfundimi dhe propozimi

Disertacioni i doktoraturës me temë “Dallimet e disa karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorike të studentët e Universitetit të Tetovës” i kandidatit Mr. sc. Blerim Sulejmani, paraqet një studim shumë të rëndësishëm në fushën e hulumtimeve shkencore të kulturës fizike dhe aktiviteteve sportive.

Rezultatet e hulumtimit, do të jenë një referencë shkencore dhe pragmatike për pedagogët, trajnerët dhe punëtorët sportiv duke paraqitur informata të rëndësishme mbi ndikimin e këtyre karakteristikave antropometrike dhe motorike në realizimin e detyrave teknike dhe taktike me qëllim të dozimit të vëllimit dhe intensitetit të ngarkesave gjatë orëve të sportit, orëve speciale si dhe aktiviteteve të ndryshme sportive. Kjo do të ndikojë në shtimin e orëve të kulturës fizike dhe sportive në kurikulimet, jo vetëm të studentëve, por edhe të nxënësëve të shkollave fillore dhe të mesme.

Nga i gjithë vlerësimi i mësipërm, Komisioni i vlerësimit të disertacionit të doktoraturës me titull “Dallimet e disa karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorike të studentët e Universitetit të Tetovës” të kandidatit Mr. sc. Blerim Sulejmani, konstaton se i plotëson të

gjitha kriteret e përcaktuara dhe i propozon Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sporteve që të aprovojë këtë raport dhe t'i lejoj mbrojtjen publike.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Isa Asllani - anëtar 
2. Prof. Dr. Metin Dalip – anëtar 
3. Prof. Dr. Fadil Rexhepi – anëtar 
4. Prof. Dr. Haki Ismaili – anëtar 
5. Prof. Dr. Prof. Visar Ganiu – mentor 